




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/ 426

Datë: 12.11.2020

PROCESVERBAL

i mbledhjes së -VI-(gjashtë) të rregulltë të Kuvendit Komunal të Malishevës

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së -IV- për vitin 2020.
2. Shqyrtimi i Projekt-Buxhetit të Komunës së Malishevës për vitin 2021.
3. Shqyrtimi i Raportit të DKAE-së, për përfundimin e vitit shkollor 2019/2020 si dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2020/2021.
4. Shqyrtimi i draft Rregullores për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme për vitin 2021.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/813 datë: 19.08.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e stadiumit ndihmës në Malishevë.
6. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/277 datë: 12.08.2020 të parashtruar nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, në lidhje me vendimin nr.02/05 datë: 10.01.2020 të Kuvendit të Komunës së Malishevës, për pezullimin e pëlqimeve për operimin e kompanive të gurëthyesve.
7. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim për periudhën Janar-Qershor për vitin 2020.
8. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Shërbime Publike për vitin 2020.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/89 datë: 01.09.2020 të parashtruar nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronësores-Juridik në lidhje me rregullimin e parcelave brenda oborreve të shkollave.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve.

11. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/255 datë:16.07.2020 të parashtruar nga shefi i grupit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës nga radhët e AAK-së, për pjesëmarrje në Komitetet e përkohshme të formuara nga Kuvendi i Komunës.

12. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/256 datë: 17.07.2020 të parashtruar nga shefi i grupit të asamblistëve nga radhët e Nismës Socialdemokrate në Malishevë, lidhur me plotësimin e Komiteteve të përkohshme të formuara nga Kuvendi i Komunës.

13. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës nr.01/914 datë:15.09.2020, sipas kërkesës nr.01/137 datë:18.02.2020 të parashtruar nga anëtarët e kryesisë së fshatit Carrallukë, për caktimin e lokacionit dhe përkrahje financiare për ndërtimin e objektit të përbashkët me rastin e organizimit të pritjeve për raste të ndryshme.

14. Ndërtimi i Çerdhes së Re pa vendim të Kuvendit Komunal si dhe caktimi i lokacionit të ri për këtë Çerdhe.

15. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/287 datë:20.08.2020 të parashtruar nga Sylë Morina nga fshati Astrazup.

16. Të ndryshme.

Ardhja e juaj është e domosdoshme. Kryesuesi i Kuvendit.

Mbledhja mbahet me datë:24.10.2020 dhe filloi në ora 10:30.Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: Kryetari i Komunës, 20 asambleistë, drejtorë komunalë.

Rrahim Morina: 20 janë prezent. Fillimisht pershendes Kryetarin, anëtarët e Kuvendit, drejtorët e drejtorive dhe gjithë të pranishmit. Propozoj që për shkak të agjendes që kemi në rendin e ditës, mos të debatohet pika jashtë rendit të ditës, por të shkohet drejtpërdrejt për rendin e ditës.

Kush është për me ngritje të dorës ?

Për: 13

Kundër: 3

Apstenim:4

Sot nuk debatohet jashtë rendit të ditës.

E hapi debatin për rendin e ditës. Kush e do fjalën?

Nëse nuk ka debatues atëherë a po pajtoheni me këtë rendë të ditës?

Kush është për me ngritje të dorës?

Për: 21

Kundër: 0

Apstenim:0

Me 21 vota aprovohet rendi i ditës. Kalojmë te pika e parë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së IV (katër) për vitin 2020.

A e don ndokush fjalën rreth Procesverbalit?

Nëse nuk ka, kush është për Procesverbalit?

Për :21

Kundër :0

Apstenim:0

Me 21 vota për aprohet Procesverbali i mbledhjes së -IV (katër) të vitit 2020.

Kalojmë në pikën e dytë :Shqyrtimi i Projekt-Buxhetit të Komunës së Malishevës për vitin 2021.

Kryetari e ka fjalën.

Ragip Begaj: I nderuar Kryesues, të nderuar asambleistë, të nderuar ju të pranishëm. Jemi në proces të miratimit të projekt-buxhetit për vitin e ardhshëm. Kisha kërkuar që qfarëdo projekti që miratohet është në të mirë të qytetarëve tanë. Kisha kërku ta bëni një analizë, kemi fshatra që nuk kanë asambleistë fare duhet të kujdesemi dhe për ato fshatra. Problemi më i madh është te pjesa e investimeve kapitale, 4 milion e sa janë qato i keni. Këto tjerat nuk mundeni me ndërhy te shtyllat as të arsimit, as të shëndetësis. Të jeni të arsyeshëm, të keni parasysh gjërat vendet ku janë investu më pak të investohet më shumë, vendet ku janë investu më shumë të investohen më pak. Kërkesë e imja është të miratohet buxheti në bazë të mundësive. Drejtori ju jep sqarime nëse keni nevojë.

Valon Mazreku: Falemenderit Kryesues! Pershendetje për të gjithë! Përpara keni dokumentin e propozuar nga Kryetari i Komunës, i mbështetur mbi Ligjin e Menaxhimit të Financave Publike dhe qarkoret buxhetore të nxjerra nga Ministria e Financave. Buxheti ndahet në total për Komunën e Malishevës sipas qarkores së parë ka qenë mbi 15,000.000 € mirëpo me qarkoren e tretë pasi është bërë rishikimi i KASH-it ka pas shkurtime buxhetore në nivelin lokal në të gjitha komunat. Komuna jonë nga këto shkurtime buxhetore është prek nga granti i përgjithshëm dhe nga të hyrat vetanake. Buxheti është shkurtuar për 318.221 € , prej tyre 88.000 € janë zvoglu te planifikimi dhe të hyrat vetanake dhe pjesa tjetër është zvoglu granti i përgjithshëm. Granti specifik i shëndetësis këtë vit ka pasur një rritje diku rreth 150.000 €, po ashtu dhe buxheti i arsimit ka mbetur i njejtë sipas qarkores së parë buxhetore. Buxheti i Komunës është afro 15,000,000 € ose 14,900,757 € .

Ky buxhet është i ndarë në pesë kategori ekonomike: pagat, mallrat dhe shërbimet, shërbimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale.

Sa i përket pagave në bazë të kështit të fundit që e kemi bërë buxhetin, rezulton që pagat për 1297 të punësuarve sa i ka organizata janë 8,363.200 € , mallrat dhe shërbimet për gjitha programet 1,529.526 € . shpenzimet komunale siq janë shpenzimet e energjisë, telefonia fikse, uji, mbeturinat janë 455 000 €, subvencionet janë 400.000 €, dhe kapitalet janë 4,153.031 €. Prej grantit qerveritar për investime kapitale janë 3.904.813 €. kurse prej të hyrave vetanake janë 248.218 €. Për pjesë tjera nëse ka diqka ,ne jemi me ju dhan përgjigje .

Rrahim Morina : Falemenderit drejtor ! Atëherë hapim debat rreth kësaj qështje?

Urdhëro, Alban Krasniqi e ka fjalën. Munësisht ju kisha lutur ta respektojmë kohën.

Alban Krasniqi: Pikërisht për kohën do flas që në fillim.Nëse duhet për mos me respektu kohën, ky është moment , kohën si procedure. Nëse na jemi me i sos minutat dhe t'i me na kqyr aty dhe me na ba presion me kry ma shpejtë, kjo është në kundërshtim me atë që e tha edhe Kryetari dhe me ata që jemi duke biseduar dhe ne,që ky buxhet me dal sa më mire i përgaditur. Kërkoj që në këtë mbledhje me pas shmangie prej qfardo kohe, qfardo procedure, secilit t'i jipet fjala në lidhje me buxhetin.

Rrahim Morina: A po pajtoheni që 15 minuta t'i kenë shefat e grupeve dhe 10 minuta anëtarët e Kuvendit ? Ju lutem me ngritje dore kush është për?

Mirë kjo u votu. Faleminderit, 15 minuta i kanë shefat e grupeve dhe 10 anëtarët e Kuvendit.

Alban Krasniqi: Të nderuar asambleistë, sot e keni përpara buxhetin ndonëse me një format të pa lexueshëm tërësisht, ky është problem numër 1 (një) pra teknik .Nuk e di sa kanë me mujt dhe asambleistat me ato mini shkronja të vogla me i përcjell dhe me kuptu se qka është shkruar brenda. Kryetari e potencoj që buxheti të jetë sa më gjithpërfshirës, të futen fshatra dhe lokacione ku nuk është investu sa duhet dhe të bahen më pak investime në ato që është ba.Shumë mirë Kryetar, po qysh mundet me ditë një asambleistë se ku është investu më pak e ku më shumë, kur nuk i ka këto informacionet bazë ,të cilat ju do të duhej të na sillnit këtu neve.

Kryetari gjithashtu tha se kemi mjete të kufizuar dhe nuk duhet me pas fontan dëshirash në hartimin e buxhetit. Shumë mire Kryetar, mirëpo buxheti të cilin e keni ju këtë vit duke e realizuar, a ka qen fontan dëshirash apo është buxhet i orientuar drejt kërkesave dhe nevojave të qytetarëve? Kryetar ,drejtori i financave e tha më heret se një pjesë e projekteve nuk do të mund të realizohen këtë vit dhe po i vendosni vitin tjetër. Kryetar, a është ky pranim i dështimit tuaj, në menaxhimin e paras publike?

A ish dasht me pas na një list të projekteve që ju nuk keni arritur t'i realizoni në vitin 2019- 2020, gjë që e kemi kërkuar dhe nuk na keni sjell. Si me dite na se cilat projekte janë përfshirë e cilat jo? Aktualish ky projekt buxhet që na ka ardhur të nderuar asambleistë,nuk është real në fakt, disa prej pjesëve që kanë të bëjnë me investimet kapitale, ne kemi marr informacion që një pjesë e tyre kanë përfundu dhe disa kanë filluar, janë të tenderuara po ne nuk e kemi atë informacion zyrtarë ,është një list që na është sjell po informacione zyrtare nuk na është sjell.

Qysh na dojm me pretendu me ba ni buxhet sipas nevojave të qytetarëve, ku ne nuk i kem këto informacione.Unë e shohë si një dështim të Kryetarit ,të cilin po don me gju në asamble,të cilin ne nuk duhet me pranu .Ne si asambleistë do të mundohemi që krejt nevojat për aq sa mundemi,që na kan sjell edhe Kryetarët e fshatrave, ku unë nuk kam qen në takim për arsye te mia personale. Kam dëgjuar që

kanë qen shumë të zëshum, dhe falenderoj për vrejjet konkrete qe i kanë bërë,unë uroj që kjo te vazhdoj tek Kryetarët e fshatrave, mirëpo i paralajmroj Kryetarët në mënyrën se si është ardh ky buxhet dhe me mungesën e informacioneve që i kem, do ta kemi të vështirë ne si asambleistë të mundemi ta menaxhojmë për arsye edhe të mungesës së informacioneve.Ne nuk dim se cilat projekte të viti 2019-2020 janë realizuar, cilat janë duke u realizuar dhe qka pritet të realizohet në këta dy-tre muajt që kanë metur në buxhet, dhe pa e ditur këtë informacion rrjedhimisht skena me ditë qka duhet me përfshirë prej vitit 2019-2020 në buxhetin 2021.

Kam dhe një lutje për ju të dashur asambleistë,që të dilni përtej egove personale dhe përfaqësimit lokalist , që nënkupton që këtu ka projekte që janë me shumë të mdhaja me shumë , pra me 700.000 € . Kryetar nuk të përket ty se cilin projekt me realizu e cilin jo, kjo nuk është në dëshirën tane, e jotja si detyrë është me i realizu, me menaxhu me sektor të caktum. Për fund të na tregosh në detaje t'i ose drejtori në vitin 2019 sa projekte nuk janë realizu, 2020 sa pritet të mos realizohen sepse edhe dy muaj janë mundësi. Nëse nuk janë realizu ato projekte, ku kan met paret e tyne? Ju faleminderit !

Rrahim Morina: Falemenderit Alban! A e don dhe dikush tjetër fjalën?

Urdhëro , Sylë Dukolli e ka fjalën.

Sylë Dukolli: Faleminderit kryesues! Pershendetje Kryetar, drejtor, koleg asambleistë dhe gjithë ju që po na përcillni. Puna më e madhe ose pika më e rëndësishme që bahet brenda një viti në Kuvend është projekt-buxheti për vitin e ardhshëm, në bazë të cilit duhet me pas drejtimin ekzekutivi me dhënien e votes nga asamblea për ecjen e projekteve që na synojn për qytetarët e Komunës sonë. Një draft e kemi marrur para dy ditëve. Një ditë jemi takuar si grupe, në emër të grupit krejt qka kanë sherby këto ,vetëm kanë sherby me marr informacione, Drejtori ka prezantuu. Krejt vonë e kam siguruar njëfar liste të cilën ne po flasim e që ndoshta nuk është e plotë dhe duhet të plotësohet nga infrastruktura, nga Drejtori i Infrastruktures .

Ne kemi kërkuar se cilat projekte janë të kryera,cilat janë në vazhdim dhe cilat synojn të kryhen sivjet. Një pjesë e projekteve të cilat na kanë dal që janë hy në draft të ri të drejtorit , Kryetarit në këtë rast, janë dhe në listen e urbanizmit që thot se këto punë janë të përfundume ,një pjesë e tyre thotë janë nisur, për të cilat na prapë kërkojm edhe qmimin e tenderit dhe ato që duhet bartur si pagesa në këtë buxhet në fillim të vitit të ardhshëm, sepse ata kur i përfundojnë , ju e dini se viti kalendarik përfundon me 24 dhjetor , mbas 24 dhjetorit asnjë pages nuk mund të bëhet .

Ne duhet me i ditë detyrimet që ka Komuna për projektet në qoftëse janë te kryme.

Cilat obligime i kemi ndaj operatorëve? Kjo është pjesë e rëndësishme ,kjo na ka përcjell në buxhetin e vitit të kalum për munges të informacioneve.

Kërkoj mirkuptim me kërkesa të arsyeshme , mos të bëjm kërkesa fontan dëshirash sepse besoni nuk

realizohen. Nëse ai projekt votohet këtu ,ai duhet me ndodh në teren, mujm me ja shtu 20-30 metra gjithkujt, nëse nuk janë llogarit letrat mirë , mirpo ai duhet me fillu,ai duhet mu implementu. mirpo ajo është çështje e ekzekutivit, e Kryetarit. Faleminderit !

Rrahim Morina: Faleminderit Sylë! Profesoresha Hidajete Mazreku e ka fjalën.

Hidajete Mazreku:Faleminderit Kryesues! Pershendetje Kryetar,pershendetje drejtor, kolegë asamblesitë.

Sa i përket projekt-buxhetit të vitit 2021, Valon a na keni bërë me qëllim në këtë format , duhet syza,mikroskop me marr me shfletu. Sa i përket projekt-buxhetit 2021 mua nuk më pëlqej krijimi i këtij buxheti, un dhe atëherë ju kam than të mirren eksperta. Këto qka janë të planifikuara këtu.qa kemi pas 2019-2020 më falni ju të fshatrave , për qytetin e Malishevës asgjë nuk është ba nga infrastruktura të ndryshme brena qytetit të Malishevës. Çdo Komunë identifikohet me qytet, shko kqyre Drenas, Skenderajin , në Malishevë ska kurgja me këto që i ka planifiku ky.

Do na lejm te investimet kapitale Kryetar . Te lumi Mirusha këto dy rrugë që kalojnë rreth lumit a i keni kompenzu pronat ? Unë kam qen kundër, asgjë nuk ka ndryshu dhe pse janë kompenzuar pronat. A ka Komuna e Malishevës mi kompenzu dhe në këtë pjesën poshtë Kryetar ?

Mu më kanë befasuar dhe kto dy tranzitet Loti 1 -Loti 2 për këto kam dëshirë me pas eksperta që planifikohen, të realizohen.

Të gjitha ato projekte 2019-2020 unë hale spo shoh as trotuare, as ndriqime,as asfalttime posaqarisht nga ana jonë. Valon ,me ty e kam t'i je i Malishevës dhe mem dal qishtu.Unë hale nuk kam has në planifikim si duhet posaqërisht për Komunën e Malishevës, se fshatrat nuk i njoh aq shumë, më falni koleg asambleist nuk kam asgjë kundër fshatrave kam dëshirë qdo cep i fshatrave të Malishevës të jetë në nivel varësisht prej nivelit që e ka. nëse është për turizëm pse mos me investu, për këtë e mora shembull liqenin e Mirushes.Përpos që janë duke e ziduar lumin Mirusha, sen jo. Tek Veselavit jo, tek mahalla gurit jo, tek Ramiz Osman 500 metra që ka qen jo, asnjësen nuk është. Më fal Kryesues ndoshta e shtyna pak ,por kam qen shumë e mllëfosur kur e kam pa në atë gjendje .

Rrahim Morina: Avdi Morina e ka fjalën.

Avdi Morina: Faleminderit Kryesues! Pershendetje Kryetar, drejtor, të nderuar kolegë. Mendoj se kjo mbledhje është e një rëndësie të veçant sepse po e përgadisim një projekt-buxhet i cili besoj se do t'i shërbej gjithë qytetarëve të Komunës së Malishevës, andaj në cilësin e asambleistit unë i ftoj gjithë kolegët e mi, pa dallim bindje politike, që bashkarisht ta hartojm një projekt-buxhet i cili ju shërben proriteteve dhe nevojave të qytetarëve të Komunës së Malishevës, duke përfshirë secilin fshat veq e veq, secilen lagje veq e veq, por qdo herë duke i respektuar proritetet dhe nevojat. Secili nga ne kemi kërkesa që vin nga qytetarë të ndryshëm për lagje të ndryshme, qoftë për

rrugë, ujësjellës, kanalizime apo rrjete të kanalizimeve, trotuare, ndriqime, mirpo ajo qka është me rëndësi që bashkarisht tju japim prioritet nevojave të kërkesave që janë më kryesore sepse është e pamundur që me një projekt buxhet që e kemi t'i realizojmë gjitha projektet të cilat qytetarët tanë kanë nevojë.

Ne duhet që fokusin tonë ta orientojmë edhe tek disa segmente tjera të jetës, të cilat janë shumë të rëndësishme, si në investimet për kulturë rini dhe sport duke ju mundësuar të rinjve tanë t'i ushtrojnë aktivitetet e tyre në këto fusha, e jo ta shohin tanë jetën e tyre në asfalt, në rrjete të kanalizimeve apo në çështjet tjera. Unë mendoj që është mirë që grupet politike të ulemi bashkë dhe ta bëjmë një projekt-buxhet i cili ka me ju shërby nevojave të qytetarëve pa dallim. Faleminderit Kryesues !

Rrahim Morina: Faleminderit Avdi ! Fjalën e ka Kastrioti.

Kastriot Berisha: Faleminderit Kryesues ! Pershendetje Kryetar, drejtor, kolegë asambleistë. Unë mendoj që në Komunën tonë edhe para Nismes, por që dy mandate që i ka Nisma, është tu u thirr në kërkesat e qytetarëve, por nuk e di deri sot cila kërkesa të qytetarëve janë plotësuar. Kryetar në qendër të Malishevës një rreth boll është i shëmtun e i vogël, por prej mbas luftës është një gropë aty, që ende asnjë qeveri nuk ka mund ta renovojë atë gropë. Më herët i keni qit disa ndërpresa nëpër rrugë, që dikah u bëjshin liqe, dika nuk mujshin me kalu makinat e mërgimtarëve dhe dul që një kompani e ka bërë gratis, ndërsa tek ne ka ardhur një shumë prej 30.000 € që ka kushtuar ai projekt dhe nuk e di kush e ka marr një vendim që i ka hek, por me të vërtetë ka bërë mirë.

Kryetar kërkesa e qytetarëve është rruga Malishevë-Mirushë. Komuna e Malishevës është njëra ndër Komunitet më të prapambetuara, ta quaj edhe mbas Dragashit. Çfarë kërkesa të qytetarëve janë të realizuara për komplet ato fshatra Malishevë-Mirushë, ku asnjë fëmijë nuk mundet me ardhur në shkollë pa kalua nëpër via të badha ka lëvizin makinat një. E dyta të gjithë ato lokale që funksionojnë anej, shikushmërin e kyqjes në rrugë e kanë të bllokime me mjete e tyre, që e kanë të padrejtë ta bllokojnë hapsirën e rrugës që i takon asfaltit.

Është ndarë buxheti që sa here për lumin Mirusha, a ka ndonjë lumë në Republikën e Kosovës më të mjerusshëm se Lumi Mirusha?

Kryetar mini tranzitin e keni renovu është mirë aq sa është, por a e keni pa te Lumi sa mbeturinat janë, nuk dihet a është deponi e mbeturinave apo Lumi Mirusha. Në lagjen "Gjesh" asnjë infrastrukturë nuk ju ka plotësuar asaj lagje asnjë rrugë, asnjë kanalizim.

E kemi Ujvarën e Mirushës, qytetarëve të fshatit Llapqev disa herë ju keni premtuar ju në këto dy mandate që do ju rregullohet një rrugë, llogaritne Klina që ka një pjesë shumë ma të vogël se Malisheva në Mirush, turistëve ju ka rregullu rrugët, ndërsa ne sikur ta kemi një marrveshje që për atë pjesë mos të interesohemi na fare.

Kanalizimet që vin prej Lladrovci në hymje të Malishevës dhe lumit që është tek stacioni i autobusëve.

është ndreq lumi ndërsa lartë kalojnë kanalizime prej Carralluke për Mirush.

Unë jam për qfardo përkrahje me ta dhënë ty si Kryetar dhe këti projekt-buxhetit vetëm nëse shkojnë për qytetarët e Komunës së Malishevës, jo për kompanit dhe interesat personale.

Falemenderit!

Rrahim Morina: Faleminderit Katriot ! Nebih Bibaj e ka fjalën .

Nebih Bibaj: Faleminderit Kryesues ! I nderuar Kryetar, drejtor ,kolegë, të nderuar përfaqësues të mediave,të dashur qytetarë. Do të lidhem pak te zotëriu Avdi Morina që tha : nuk ka nevojë për kanalizim në Komunën e Malishevës, ndoshta i ka ik pak por është shqetësuese kjo punë sepse Komuna dhe investimet duhet mu koncentru më shumë në kanalizime, duke i larguar ujrat e zeza sepse e kemi ndotur Ujvaren e Mirushes.

Projekt-buxheti që e keni pru, unë i kam dy-tri dokumente ktu , një Plan Prokurimit dhe një buxhet që është votuar në 2019 për vitin 2020 dhe kam një buxhet të masakruar nga ju që e keni planifikuar për 2021. Unë e shohë këtu një mospërputhje të madhe mes këtyre tri dokumenteve që i keni pru, keni shkput projekte jashtëzakonisht të mdhaja, keni ndal projekte, është mire mu ba real para Kuvendit dhe para qytetarëve me i pru borgjet. Ku janë këto borgjet që Komuna i ka? E dyta me i pru projektet e vitit 2019 të cilat nuk janë realizuar dhe cilat janë në prokurim publik, projektet e vitit 2020 cilat projekte janë në prokurim publik?

Ne po dojm me ju ndihmu por ju spo doni me i ndihmu vetit, kjo është pak shqetësuese.Nëse thae Kryetar që jam Kryetar i gjitha fshatrave atëherë shtriu në gjitha fshatrat, po të garantoj se mbi 80% të këti projekti-buxheti të 2021 të qojnë drejtë te dyrt e një zyrtari të Nismes. Faleminderit !

Rrahim Morina: Demir Bajra e ka fjalën.

Demir Bajra: Faleminderit Kryesues ! Përshendetje Kryetari Begaj,pershendetje kolegë të asambles.Ne duhet të jemi real që edhe pozit edhe opozit duhet t'i pranojm kritikate ndërsjellta. Unë nuk pajtohem që projektet e 2018 me i disku për 2021, nuk pajtohem që projektet e 2020 me i disku për 2021 sepse kanë mbet zvarr ato. Një shqetësim tjetër për Panorc që kisha kërku nga gjithë kolegët këtu , na në Panorc e kemi një ujësjellës por kostoja e shpenzimeve tona sa ka ndodhur është marramendse,un e kam shti si proritet ujësjellsin e fshatit Panorc dhe kërkoj mbështetjen dhe nga Kryetari Begaj por edhe te kolegët në votim të buxhetit të jemi të kujdesshëm.

Dhe një shqetësim, ju e dini që një rrugë është shtruar për në ujvare, nga fshati Llapqev dhe aty kisha dëshirë të vije deri te realizimi i asaj rruges me asfaltim sepse është në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës. Ujësjellesi Panorc-Llapqev e kemi një shqetësim shumë të theksum te çështja e ujit. Kërkoj nga asambleistat që të jemi korrekt dhe të votojm projekte të cilat janë jetësore për ne. Ju faleminderit !

Rrahim Morina: Sadije Krasniqi e ka fjalën.

Sadije Krasniqi :Faleminderit Kryesues ! Pershendetje Kryetar,drejtore të pranishëm,kolegë asambleist dhe gjithë ju të pranishëm në sallë .Sa i përket buxhetit për vitin 2021 është një buxhet gjithëpërfshirës dhe janë të përfshira gjitha fshatrat. Lista e kërkesave është më gjerë por për shkak të pa mundësis,për shkak të këtij buxheti të limituar që kemi andaj janë në buxhet këto projekte. Te bujqësia krahasuar me vitin e kaluar kemi një ngritje të buxhetit për sektorin e bujqësis,që konsideroj që është pozitive. Kërkesa ime është që shkolla ``Bajram Curri`` të përfshihet në këtë buxhet, në rinovim dhe në aneks. Të nderuar kolegë kërkoj mbështetjen e juaj. Faleminderit !

Rrahim Morina: Valoni e ka fjalën.

Valon Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Pershendetje për Kryetarin e Komunës Ragip Begaj,pershendetje për Kryesuesin e Kuvendit ,gjithë kolegët dhe gjithë të pranishmit që janë në këtë sallë. Të nderuar kolegë, të nderuar qytetar të Komunës së Malishevës , projekt-buxheti është një ndër pikat më të rëndësishme edhe për qytetarët e Komunës së Malishevës. Sa i përket projekt-buxhetit për vitin 2021 që e ka parapar drejtori i financave, unë konsideroj që ky Kuvend nuk duhet të aprovoj apo të parasheh investime tjera për vitin 2021, e t'i largoj projektet e viteve të më hershme. Projektet 2019-2020 të cilat nuk janë të parapara në vitin 2021 unë mendoj se këto projekte i mbron ligji. Rrugët me kubza që nuk janë parapa për vitin 2021 për gjithë ato fshatra të Komunës së Malishevës duhet mu rikthyer në projekt-buxhetin e vitit 2020 . Gjatë viteve të kaluara kemi pasur edhe parqe, parku në Terpez të poshtme që ende ska përfunduar projekt i vitit 2019 ,po ashtu parqet tjera në Carralluk,Astrazup mos ta theksoj në Bardh për shkak se në momentin që po e permendi fshatin Bardh po ndodh menjëher një fluks. Në fshatin Gullubofc asambleja Komunale në vitin 2019 i ka parapa 800 metra asfalt ,600 metra për lagjen ``Dashec`` dhe 200 metra në lagjen ``Hoxhaj``, kurse aty ka ndodhur një devijim dhe 450 metra janë duke u kryer në lagjen ``Hoxhaj`` kurse 350 metra në lagjen`` Dashec``. Po ashtu pajtohem me parafolsen Sadijen me u ndërtuar palestra sportive në shkollën ``Visar Krasniqi`` ndërsa kjo palestra tjetër le të mbetet tek shkolla ``Bajram Curri``. Ne është mirë me nda një buxhet që të kemi mirmbajtës në qdo fshat të Komunës së Malishevës. Në fshatin Dragobil Kuvendi Komunal nuk ka parapar shumë investime. Unë jam për një bashkupim që kësaj radhe të dalim unik se është e mirë edhe për qytetarët e Komunës së Malishevës. Faleminderit !

Rrahim Morina: Urdhëro , Sylë Dukolli e ka fjalën.

Sylë Dukolli: Faleminderit Kryesues! Sqarimi im është që t'i ruajm gjakrat, këtu jemi që buxhetin me ba bashkë e me qu në gjitha fshatrat. Unë mbas vendlindjes time më së shumti i dua fshatrat rreth maleve sepse jam strehuar dhe kemi ba luftë andej dhe janë fshatrat më të bukur dhe më mikpritës. Unë për kolegun tim Demirin kërkoj që ta mbaj veten, nganjëher duhet mi mshel syt sepse gjithë gabojmë, mirpo ta kemi një kilim të përbashkët që t'i qojm gjërat përpara. Kërkoj respekt të dyanshëm.

Rrahim Morina: Urdhëro Kryetar.

Ragip Begaj : Gjitha këto kërkesat dhe shqetësimet e juaja për shumë projekte janë reale, unë e pranoj se disa nuk janë kry e disa besoj se do të kryehen. Kam një bindje që viti 2019 ka mu kry të gjitha ato projekte ato qka kanë hyrë në procedura. Demiri pyeti për rrugën e Llapqevës, ja kemi ndërpre punën asaj kompanie, e kemi derguar në Gjykatën e tenderve me dënu, me fut në listen e zezë, nuk e kanë futur në listen e zezë edhe ka fillu me marr punë prapë te ne, ka kështu lloj raste plotë .Kam bisedu edhe me ministrin nese mundën me na ndihmu edhe ata sepse e kemi pasur projekt të përbashkët me ta, jo vetëm Komuna.

Kanalizimet janë shqetësuese për ne merreni në pozicion dhe ndanë për kanalizime. Shqetësimi jonë si Malishevë është çështja e ujit kemi thatësi të madhe dhe kemi probleme të mëdha, po shpresohet që do të lidhen këto dy sisteme Radoniq dhe Iber Lepenci, nëse na ndodhë ajo me përkrahjen edhe te nivelit qëndror do të jetë një zgjedhje për Malishevën, ose për ndryshe për ujë ska zgjedhje Malisheva.

Ujësjellsit që i duhet përforsim është ide e imja. Ne kur e kemi të parapamë në buxhet edhe nëse nuk janë të gjitha mjetet, mund të gjenden donator, është problem Bellanica i kemi ndar 100.000€ nuk kemi mund ta realizojm projektin atëherë, është problem tash Bubaveci që është një vend që ka mundësi të mirret ujë. Te lagjja "Mirdita" ne duhet ta kemi parasysh që ta kemi një pjesë të mjeteve së pari duhet të bëhen kanalizimet nuk mundet të bëhet ndërtimi aty, kanalizimi, rryma ,uji pastaj të asfalttohet rruga këto gjana duhet te mirren parasysh se kemi nevojë edhe aty te investohet. Për kanalizime në përgjithësi do tja fillojnë nga Bubli e deri në Temeqin kemi probleme me kanalizim.

Çështja e rrymës është një fat i madh, edhe ky është projekt i Qeverisë tone, tash ajo po bëhet realitet po vjen 220 kilovatesh në Malishevë edhe është një projekt diku 13 milion €, janë të përfunduara të gjitha procedurat.

Ujuni dhe harmonizoni gjanat në ato fshatra ku kemi nevojë me nda mjete për ujësjells, për kanalizime edhe për gjana të tjera. Me ndriqim po bëhet Malisheva nuk jemi keq ta kemi parasyshë.

Rahim Morina : Faleminderit Kryetar! Atëherë në ora 13:15 shihemi.

Rrahim Morina: 16 janë prezent. Ilaz Krasniqi e ka fjalën.

Ilaz Krasniqi : Pershendetje për të gjithë ! Ne këtu do ta kishum më lehtë sikur t'i kishim pasur të dhënat për me u orientu sepse kemi shumë kërkesa të qytetarëve, të cilat kanë qen të planifikuara po nuk janë kryer sot. Në fshatin Terpez e ulët nuk është kry asnjë projekt i planifikuar që ka qen në buxhet, problemi është te rruga "Adem Jashari" ka qen trotuari 200 metra që nuk është kryer ,ku janë të rrezikuar fëmijët që shkojnë në shkollë.

Përveq që kemi problem me ujin e pijes,që ujësjellesi nuk po mund me i furnizu qytetarët me ujë të pijes, ne me këto kanalizime ja kemi dëmtuar dhe ata pak ujë që e marrin nga puset e tyre, sidomos kanalizimi nga Terpeza e ulët deri afër Mirushes. Kisha kërku që këto kanalizime të rregullohen sepse dhe ato që janë ba, janë ba keq. Në projekt-buxhet 2019-2020 po flas për fshatin Carralluk nuk janë realizu , mirpo është mirë që qdo projekt të parashihet se ku është me më proritët, ku është më rrezik.

Projektet të cilat kanë qen të planifikuara nuk kanë gjetur miratim dhe shumë prej projekteve kanë devijuar përshebull në fshatin Mleqan lagjja "Sylë Imeri" nuk ka qen e planifikuar, rruga "Fatime Sokoli" dhe te lagjja "Sokoli" janë tri rrugë që janë shtru në Mleqan dhe nuk kanë qen të buxhetune. Në fshatin Në Llozic keni qu rrugë te vorrezat 150 metra, në fshatin Vërmic gjithashtu keni ba rrugë te vorrezat e fshatit 300 metra kurse është kërkesa prej shkollës te lagjja "Raqaj" është 300 metra rrugë dhe janë mbi 20 shtëpi nuk e keni parapa që aty të shkon rruga. Faleminderit!

Rrahim Morina |: Alban Mazreku e ka fjalën.

Alban Mazreku:Pershendetje Kryesues,drejtore të qeverisjes komunale,të nderuar asambleistë.

Ky projekt-buxhet është gjysmak, për shkak se dhe propozimet që kanë qen për vitin 2020 pothuajse nuk janë futur në buxhetin e vitit 2021-2023. Te bashkë financimi që e keni parapar edhe buxhetin e kalum edhe për buxhetin 2021, na e kemi një vendim të vitit 2019 ku e kemi marr për rregullimine varrezave të lagjes "Hoti" është vendim i vitit 2018 që nuk është realizu.

Drejtori i Urbanizmit në raportin e tij e ka shenu që janë 3600 € në fshatin Bubël për vendosjen e trupave ndriques. Realisht aty janë vetëm 15 drita që i ka ngjit aj punë kryersi, nëse 15 drita bajn 3600 euro, nuk po e di a i kanë ngjit edhe shtyllat apo vetëm dritat sepse shtyllat sa e di kanë qen të vendosura.

Valon, desha me cek dhe çështjen e deponis të mbeturinave në lagjen "Hoti" ku një qytetar i shkruan në faqe të Nismas ku kërkon një sqarim se pse nuk po hiqet deponia e mbeturinave në qytetin e Malishevës? Pergjigjja aty thuhet në emër të nënkryetarit Berisha që fajet për këtë i ka opozita në Komunën e Malishevës, gjë që nuk është e vërtet. Ne kemi kërku me tërhek atë deponi të mbeturinave .

Valon, në buxhet nuk e pash kerku renovimin e trotuareve në Komunën e Malishevës ,mirpo është mirë me parapa renovimin e trotuareve në qendër të Malishevës.

Drejtori i Arsimit prof.Blerim, disa shkolla kanë kabinete të ndryshme nëpër objektet e tyre ,por në disa shkolla nuk ka kabinete. Në shkollën "Ibrahim Mazreku" është kabineti i fizikes mirëpo nuk kanë vend

ku me vendos, ishte kërkes e një mësimdhënësi që të paktën me na pru disa ormana për mos me u prish ato paisje.

Rruga "Pavarsia" te lagjja Veselaj nuk është rregullu ajo rrugë dhe ka qen e planifikume për vitin 2019 për 2020. Rregullimi i oborrit të shkollave , ka buxhet për shkollën fillore "Ibrahim Mazreku" ka buxhet dhe për shkolla tjera për rregullimin e oborreve tyre si dhe fushave sportive të tyre por prap se prap në të njëjtën gjendje po jesisin ato. Shkolla "Ibrahim Mazreku" ish duhur me qen më e veqanta në raport me shkollat që janë nëpër fshatra.

Në fshatin Panorc ka qenë e planifikuar për vitin 2020 rruga "Xhevdet Sahitaj" një pjesë mu shtru asfalt plus ndriqimi, asnjana nuk ka ndodh dhe nuk është në buxhet e planifikum as në vitin 2021. Zgjerimi i rruges "Adem Jashari" dhe rruges "Imer Krasniqi" me shku paralel drejtor janë shumë të rrezikum ajo pjesë për trotuar. Rregullimi i rruges për rreth shtratit të lumit Mirusha në drejtim të mini tranzitit, nuk është hera e parë që ka qen e planifikume, është planifiku në vitin 2018 nuk u investu kurgja,u planifiku 2019 prap su ba asgjë, tash e kemi prap në vitin 2021. A mundesh me u betu drejtor që ke me realizu këtë projekt?

Nuk është e parapame rruga që lidhet për ujvare të Mirushes prej fshatit Llapqev, nuk është e planifikuar rruga që lidhë fshatin Dragobil me fshatin Gajrak, dhe rruga prej lagjes "Danajve" në drejtim të varrezave të dëshmorëve. Faleminderit!

Rrahim Morina: Urdhëro Arlind!

Arlind Morina: Pershendetje Kryesues, të nderuar drejtor. Edhe unë i kam disa shqetësime për devijimin e projekteve. Projektet e vitit 2019 në fshatin Astrazup janë devijuar, vetëm tri rrugë me asfalt janë shtruar tash në vitin 2020. Rruga "Fazli Morina" dhe rruga "Isuf Qerkini" që të dyat kanë qasje në rrugën kryesore janë hekur nga buxheti. Propozimet e mia për vitin 2021 janë që të përfshihen këto projekte: Kanalizim rruga "Ibrahim Mazreku" 500 metra ,rruga "Qerim Bajraktari" projekt i vitit 2019 që nuk është realizuar 200 metra, rruga "Belakut" që ka qen në vitin 2020 por që është hek 500 metra,rregullimi i prockes që është parapar në 2020 por nuk është punuar në atë drejtim, dhe mbjellja e drunjëve dekurues, trotuar rruga "Shpëtim Robaj" 100 metra, rruga "15 Maturantët" 200 metra dhe rregullimi i oborrit të shkollës i cili është në gjendje të mjerueshme .Këto janë kërkesat e mia .kërkoj përkrahje nga kolegët asambleist. Faleminderit!

Rrahim Morina: Hashim Vrenezi e ka fjalën.

Hashim Vrenezi: Pershendetje për të gjithë! Po më intereson disa zëra buxhetor, Valoni me më tregu qka kanë menduar me këta zëra buxhetor me ba ? Pagesat për përfitues individual 220.000 € qka përfshihet

këtu dhe cilat kategori janë përfitues të këtyre subvencioneve individuale ?

Te programi buxheti i shëndetësisë janë do zëra buxhetor, do nuk po shihen se kur i ke printu të kanë ik shkronjat po është 4.8 - 4.5 edhe 4 , unë po e shoh vetëm një pjesë që pot thot teknike medicinale dhe administrat H 68-69. Shërbimet e ndryshme shëndetësore 62.000 euro ,qka keni menduar me përfshirë brenda kësaj kategorie ?

Paisjet speciale mjeksore mobile, ku kanë me shku këto mobile.

Te arsimi parafillor, fillor dhe këtu kemi shërbime kontraktuese tjera, këta zëra buxhetor vazhdimisht jemi duke e ngritur zërin që mundësisht me na i specifiku, me na tregu qka përfshihet në këto shërbime kontraktuese ? Paisjet tjera 27.519 €, kjo është shumë e thatë me e prezantu, duhet me ditë qfarë paisje tjera janë ato. Furnizimi me ushqim dhe pije, jo dreka zyrtare është 30.000 €, për qka është Valon kjo? A keni parapar sivjet futjen e shujtave për nxënës sikur viteve të tjera që i kemi pas?

Mirmbajtja e ndërtesave 21.500 € dhe mirmbajtja e shkollave. Cilat ndërtesa dhe cilat shkolla mendoni me i mirmbajt ?

Sa i përket investimeve kapitale është mirë me na pru koficientat e qmimit të tregut për projektet kapitale . Ndërsa te pjesa e asfaltteve ne e kemi pasur rjë takim me kryetarët e fshatrave, prej disa kryetarëve të fshatrave kemi marrur vrejte si Kuvend Komunal që na po aprovojm gjana po i qesum në letër edhe Kryetari i Komunës e hedhi fajin në drejtim tonin që këto kokan fontan dëshirash. Ka pasur rrugë me kocka, por nuk e di interesi u kujt është me i hak rrugët me kocka, unë propozoj që rrugët me kocka të kthehen mbrenda buxhetit.

Në vitin 2019 ka qen e planifikume një kanalizim që lidhë Maralin me Pagarushen që i përfshin 5-6 fshatra Dragobil, Marali,Maxharr,Janqist,Shkoze edhe përcillet kanalizimi për Pagarushë dhe me vazhdu te poshtë, në të ardhmen me shku te një impiant ku do të vendosen në një pjesë të përshtatshme për mos me u ba ndonja e ambientit. Kanë qen dy rrugë të planifikuara për fshatin Marali diku 600 metra asfaltim rruga "Mulla Selimi" dhe rruga "Naim Frashëri" dhe anjëra nuk janë të asfaltuara. Në vitin 2020 kanë qen të planifikuara një rrugë që lidhë fshatin Marali me fshatin Maxharr 680 metra .të pakten për Marali nuk është punu kurgja .

Në hyrje të fshatit Marali është një ish kru që tash është i shterrur i thojn Kroni i Smajlit, sa here që ka vërshime ajo rrugë bahet a pa kalueshme, kanë qen të planifikura 100 metra një lloj shkarkimi i ujrave atmosferik me ba një kanal dhe ajo ska ndodh. Në Marali është punu një trotuar në vitin 2017 në kohën e procesit zgjedhor është punu shkel e shko , besoni kolegë me shku me pa mendoni që është shtru para 30 vjeteve e jo para 3 vjete , dhe në atë pjesë të drejtimit të trotuarit 60 metra janë ndërpre, nuk e di arsyen pse janë ndërpre 60 metra trotuar. Cili është qëllimi që kjo pjesa është mbetur pa trotuar?

Ka qen i planifikuar Aneksi i shkollës Marali, me mundësu funksionimin e mësimi me një ndrrim. i

nderum drejtor mirpo nuk e di pse ju si njësi kërkuese nuk keni kërku me qit në tender ma herët këtë aneks. Opozita ju ka përkrah në qdo vendim që ka qen në të mire të qytetarit. Ju faleminderit !

Rrahim Morina: Dje e kemi pasur një takim me Kryetarët e fshatrave, kërkesa e tyre është që të futen projektet e vitit 2019-2020 që nuk janë realizu në buxhetin e vitit 2021. Duhet të ketë proritete edhe në projekte, mos të shtrohet asnjë rrugë me asfalt pa u kry kanalizimi dhe ujësjellësi. Konkretisht po e përmendi rrugën te na që është planifiku me u shtru në asfalt, ndërsa kanalizimi nuk është planifiku. Sivjet ka me hy ujësjellësi dhe vitin e ardhshëm nuk është planifiku kanalizimi që ka qen në vitin 2020 por është hek. Nuk është bërë specifikacion i rrugëve me emër dhe mbiemër. Të gjitha rrugët kanë emër, janë shënuar vetëm emrat e lagjeve. Brenda lagjeve ka emra të rrugëve, është dashur të specifikohen me emër të rruges. Shumë projekte të vitit 2020 nuk janë implementu nuk janë parapa as vitin 2021, për mendim timin është dashur me u përfshi të gjitha projektet.

Në fshatin Rudë i kanë parapar asfaltimin e rrugëve në tri lagjet, e nuk e kanë parapar rrugën "Johan Gete" që ka qen e planifikuar në vitin 2020. Rrugët e fushave përsëri nuk janë planifiku, ka qen një kërkes e banorëve që këto rrugë të shtrohen së paku me zhavor dhe të bahen të kalueshme. Ju faleminderit!

Alban Krasniqi: Kryesuesi është dashur ta kërkoj prezencen e Drejtorit të Urbanizmit, meqenëse, fatketsisht krejt qka po flasum është sfera e urbanizmit, që kanë të bëjnë me investime infrastrukturore që e prekun dhe fushen që ai është duke i kryer ose mos i kryer ato punime dhe nëse ka dështim të projekteve për shkak të mos realizimit të planit të Prokurimit, atëherë një përgjithësi të madhe e ka Drejtoria e Urbanizmit ,sepse prej andej dalin projektet, planifikimet dhe Drejtori i Financave është për një rol krejt tjetër.

Ato informacione që ne i kërkuam më herët, nëse nuk i sillni, unë nuk do ta përkrahi këtë buxhet i cili vjen pa dhënë informacione. Një aspekt tjetër që nuk u prek është buxhetimi gjinor. Disa prej investimeve si ndriqimi, trotualet por edhe rrugët e kanë dimensionin gjinor pra më lehtë mundën me dal vajzat, grat dhe të kenë akses. Siguria rritet më shumë në ato lagje ku shtrohet trotuari dhe ndriqimi, por janë dhe aspekte të tjera që lidhen me buxhetimin gjinor duke filluar dhe prej zyres për barazi gjinore, e cila e ka një funksion shumë të ngusht që i ka dhënë qeverisja dhe në një fare mënyre është dhe përgjegjësi e zyres që dhe ajo me sjellë projekte, ide edhe fushës infrastrukturore por edhe fushave të tjera që mundën me lehtësu gjendjen jetësore të grave dhe vajzave sidomos nëpër fshatra .

Drejtor, për subvensionet dhe për shërbimet të na jepet një sqarim më i detajuar ,se ka do të shkojnë dhe si janë planifikuar mu nda në bazë të kategorive, marrveshja e Hendikos-it, fondi për grat me fëmijë të posalindur.

Projektet që zhvillohen në Malishevë, sidomos ato që prekin infrastrukturen e cila ndikon në gjithë territorin e Malishevës, të bëhen me planifikime të duhura dhe me cilësi të duhur .

700.000 € të ndara për projektin që kalon rrugë nëpër livadhe asnjë shpi nuk e lidhë, është shumë i mirë si atrakcion, por unë mendoj që ai është i hershëm për mu ba, pa e ba harten zonale. Është mirë me hek këtë projekt dhe duke e hekur këtë projekt 20 fshatra kemi me i përfshi në projekte që ata i kanë esenciale. Kërkesat e fshatit Mirush janë prej rregullimit të parkut me kubza, rregullimi i diges së liqenit, ndriqimi i rrugicave, asfaltimi i disa rrugëve, trotuar në rrugën “Imer Krasnqi”, kanalizim në disa lagje të fshatit diku 300 metra dhe largimi i ujrave të zeza nga liqeni, renovimi shkollës dhe ndërtimi i fushes sportive. Fshati Guriq : asfaltimi i rrugëve brenda fshatit rruga “Minjera” rruga te “Xhamia” rruga te lagjja “Mustafaj” rruga “Pejt Bahtiu” “Hazir Guriqi”, “Kreshnikët”, “Osman Lahi”, rruga te lagjja “Bajramaj”, “Rinia”, “Luboteni”, rruga “Hidajet Mazreku”, hapja e rruges së kodrave 1400 metra , kanalizimet lagjja “Sherifaj”, “Limanaj” lagjja “Lahaj”, “te Xhamia”, rruga “Dëshmorët e Guriqit” 300 metra, rruga “Minjera”, trotuar te “Dëshmorët e Guriqit”, rregullimi i oborrit dhe rrethojës së shkollës. fushë sportive , paisje me kabinate përkatese, ndriqim publik, riparimi i kanalizimeve. Në Llozic lagja “Foniqve” lagja “Buzhalve”, “Javorve”, “Zogaj”, “Dobruna” dhe rregullimi i oborrit të shkollës dhe fushës së sportit. Te Rudi kanë kërkuar rregullimin e ujës jellësit të fshatit Rud, asfaltimi rrugëve “Johan Gete”, “Hysni Rudi”, “Vesli Klark”, “Hoxhë Cena”, trotuar, ndriqim , kanalizim. Për fund na i sjellni informacionet e projekteve të realizuara, të tenderuara me kontrat të shkruara dhe të pa realizuara 2019-2020. Faleminderit !

Rrahim Morina: Urdhëro Nebih!

Nebih Bibaj: Faleminderit kolegë! Mirserdhe Drejtor i Uranizmit, urime detyra.

Ne para dite kërkuam disa dokumente për projektet 2019-2020 prapë nuk i keni sjellë. Projektet 2019 në fshatin Lladroc të cilat nuk janë realizu, është trotuari nga Balaj deri te shkolla që është rruga me rrezikshmëri të lartë, ndoshta është faji i drejtorit të kalum që nuk është tenderu fare 660 metra. Është një rrugë me kubza që ka mbetur 200 metra, këto janë projekte të vitit 2019 që nuk janë realizu. Për vitin 2020 asnjë projekt i mundshëm nuk është realizu, të cilat kanë qen të buxhetune për vitin 2020 , rrugë me kubza ka 440 metra, asfaltim të rrugëve 485 metra, trotuar lagjja “Tanashefc”. Faleminderit !

Rrahim Morina: A po pajtoheni që leximi i dytë të bëhet me date 29 në ora 10:00 ?

Të marten në ora 10:00 mbahet vazhdimi i mbledhjes.

Ahmet Morina : Pershendetje për të gjithë ju asambleist! Sa i përket projekteve te aspekti i rrugëve edhe viti 2019 edhe viti 2020 të gjitha rrugët do të jenë të përfundume ,disa janë në ekzekutim dhe disa janë në tenderim, kështu që nuk kemi me la asnjë rrugë për vitin 2019-2020 për secilin fshat do ju japim veeq e veq të gjitha rrugët që janë të përshkrume. Rrugët private që janë nuk shtrohen, do ndërpritën.

Alban Krasniqi: Drejtor , janë dy projekte, dy fshatra që i ke deviju t'i me të tjerët, projektin e ndriqimit. Shkolla në Llapqev i ka trupat e përcaktume në të dy anët e rrugës. Shkolla në Vermic fshati Vermic ndriqimi në të dy anët e rrugës, njëra anë është që shkon për Llozic tjetra që shkon për Drenoc. Te Terpeza Ulët , ku pritet në stacion , një dritë ka qen e parapame mirëpo nuk u ngjit as ajo .ndriqimi kish mundësu që automjetet me pas shikueshmëri ma të mirë dhe qytetarët mu ndi më të mbrojtur. Ahmet nuk i ke ngjit ato, i ke qu shumë ma nalt dhe i ke shti brenda lagjes.

Rrahim Morina: Drejtori i Arsimit e ka fjalën.

Blerim Thaqi: Faleminderit Kryesues! Pershendetje për ju asambleistë, qytetarë të nderuar, kolegë drejtor. Sa mjete janë shpenzuar për tenderin për shujta të nxënësve, deri kur ka qen tenderi dhe a ka vazhdu tutje ? Për vitin 2019-2020 janë shpenzu 115,293.75 janë të kontraktuara për 58 ditë edhe 49,894.50 kanë qen pjesën e dytë semestrin e dytë por shkaku i pandemis nuk është mbajtur mësimi dhe me vendim të task-forces ende nuk kemi fillu.

Ndërtimi i fushave sportive në shkollën fillore "Sali Bytyçi ", ndërtimi i kësaj fushe është planifiku dhe është në procedur.

Prej 13 marsit shkollat kanë qen në mësim online, sipas statistikave të shkollave mbi 90 % ndjekshmëria në tv, ndërsa rreth asaj se sa ju kanë përgjigjur mësimdhënësve rreth detyrave është 80 % i përgjigjjeve të nxënësve ndaj mësimdhënësve. Gjatë kohës së pandemis shkollat janë mirëmbajt dhe ka pas një kujdes duke shpresu se do të kthemi në shkolla, mirëpo ka qen e kufizuar edhe pjesmarrja e stafit, e mësimdhënësve dhe teknikëve që të jenë nëpër shkolla. Kabineti i fizikes në shkollën "Ibrahim Mazreku", fatbardhsisht e kemi këtë shkollën e re që në vitin 2021 fillon dhe do të krijohen hapsira më shumë në shkollën "Ibrahim Mazreku".

Shkolla e Maralies , na nuk mujm me inicu qysh është aneksi i shkollës në Marali pa e pas projektin prej Uranizmit, na e kemi ba kërkesen në Urbanizëm për projektin e aneksit në Marali dhe në bazë të asaj që na është thënë në teren, nuk ka pas mundësi aneks dhe është dasht të ndryshohet projekti dhe është në procedure.

Rrahim Morina: Hapi debat rreth kësaj pike. Nebih Bibaj e ka fjalën.

Nebih Bibaj: Unë kam vetëm dy pyetje që kanë ardhur prej Vermice. E para është te emërtimi i shkollës. janë kryer të gjitha procedurat e mundshme, pse nuk po kryhet mu emërtu shkolla dhe e dyta flitet që në Vermic janë vetëm tre dezinfektues dhe nuk ka mbatës të temperatures digjitale, na trego a ka apo nuk ka. Faleminderit shumë.

Rrahim Morina : Alban Krasniqi e ka fjalën.

Alban Krasniqi : Faleminderit Kryesues ! Ne si Lëvizje Vetëvendosje kemi pasur një thirrje ku ka pasur të diskutohet gjendja e Covidit dhe marrja e masave nga Komuna dhe fatkeqësisht nga neglizhenca e juajen ajo mbledhje ka dështuar . Fatmirsisht në mbledhjen e radhes është caktuar një komision për tu marr me qësjtjen e adresimit të problemeve që qytetarët i kanë.

Në raportin e drejtorit tek rekomandimet i ka paraqitur disa kërkesa të cilat unë mendoj se duhet me i shumëfishu dhe po ndërlidhem me buxhetin ku kabinetet nuk i pash, nuk e di a kanë kërkesa ndonjë shkollë tjetër por kërkes zyrtare në buxhet nuk janë hy.

Drejtor shkollat të cilat janë hapur për process mësimor , a kanë ujë, a kanë mjete higjeniko sanitare. Shkolla “17 Shkurti” në Bajë maksimumi ka dy orë ujë gjatë ditës, identifikojë problemin dhe bëje zgjidhjen. Salla sportit është e mjerueshme, pike gjithandej. Problem është dhe me rrethojat e shkollës. Problem shqetësues është rënia drastike e numrit të nxënësve. A ka mundësi me na njoftu sa është tash ajo shifer që na ke dhënë a është shtu apo sa nxansa mungojnë që nuk e ndjekin mësimin nëpër shkollat tona. Sa ushtrues detyre të drejtorëve i kemi, qe sa kohë janë ata ushtrues detyre dhe pse nuk shpallen pozitat e tyre? Faleminderit!

Rrahim Morina: Sadije Krasniqi e ka fjalën.

Sadije Krasniqi : Pershendetje për të gjithë! Drejtor unë kam disa pyetje për ju dhe kërkoj që të bëhet digjitalizimi i shkollave dhe të punohet në këtë aspekt.

Pyetjet drejtor ishin këto |:

- 1.Në raport e keni cekur që është realizimi i projektit E-shkollori , si po funksionon, sa shkolla janë përfshir në këtë projekt dhe a është funksionalizuar E-shkollori?
2. Këshilli për verifikimin e nxënësve me nevojat të veqanta, si po funksion ky këshill ?
- 3.Pytja tjetër është kur donator e cilësisë, këtë vit a do të angazhohen apo jo?
- 4.Pytja tjetër që është shumë e rëndësishme dhe e nevojshme për shkollat tona, angazhimi i petagogëve dhe psikologëve nëpër shkolla, kur e dim se mungojnë petagogët dhe psikologët nëpër shkollat tona.
- 5 Si është bërë furnizimi me tekste shollore në këtë vitë ?
- 6 Furnizim me mjete higjenike, kur e dim që jemi në kohë pandemie dhe nevojat janë që sa më tepër të kemi material higjenik.
7. Autonomia financiare e shkollave, do të punohet në këtë drejtim apo jo ? Po të ishte autonomia financiare e shkollave ndoshta shkollat më mirë do t'i adresonin kërkesat e tyre . Faleminderit !

Rrahim Morina: Halil Morina e ka fjalë.

Halil Morina: Faleminderit Kryesues për fjalën. Të nderuar drejtor,i nderuar drejtor Arsimit.faleminderit dhe për pyetjet e KPF-ës. Drejtor unë kam një kërkesë. E di që masat anti Covid, zbatimi i këtyre masave

bëhet individualisht prej shkollave, na jemi me një situatë pandemike, ju kujtohet në kohën e karantinës kur u largu karantinimi dhe u shkaktua një hapje e menjëhershme e njerëzve që na kushtoj me përhapje të madhe të Covidit dhe me raste që shumë qytetarë tona kanë vdekur prej kësaj situatë. Tani ka nis numri me ra dhe ka nis mu kthi njëfar gjendje e normalitetit, mos ta bajm gabimin që e kemi bërë në atë kohë. Kërkoj prej teje që me ba presion ndaj drejtorëve të shkollave me i respektu qato masa që na i kemi marr.Një çështje tjetër, shkolla nuk bënë as në gjendje normale me mbet pa ujë e leje në kësaj situatë pandemike dhe këtë me shqyrtu se pse ska ujë dhe qysh mujm me evitu këtë problematik. Si drejtori e arsimit duhet me punu me i pajisur qoftë nxënësit, qoftë mësimmshënësit me paisje teknologjike. Faleminderit !

Rrahim Morina: Fjalën e ka Ilaz Krasniqi.

Ilaz Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Kam një pyetje për drejtorin e arsimit Blerim Thaqi. Ditën që janë hapur shkollat, unë e kam ndi për obligim të jem në shkollën "Imer Krasniqi" dhe "Elmi Hoti" ku këto dy shkolla kanë qen mirë të pajisura me dezinfektues dhe me gjana tjera por na kanë njoftuar se disa shkolla e sidmos aty ku janë drejtorët, ushtrues detyre nuk kanë pasur dezinfektues ose kanë pasur shumë pak. Shkolla në Vërmic ka pasur vetëm dy dezinfektues .

Në shkollën në Carralluk nuk ka ujë të pijes. ujë për me mirëmbajt shkollën nuk ka. Pyetja tjetër është a do të vazhdoni me shujtat për nxënësit. Faleminderit!

Rrahim Morina: Hidajete Mazreku e ka fjalën.

Hidajete Mazreku: Pershendetje drejtor ! Sa i përket raportit të arsimit, besoj se në pika të shkurta është e përfshime, do gjana që duhet .Unë ju uroj sukses dhe vit të mbarë që keni filluar mësimin. Drejtor mu më tepë më intereson vlersimi në aspektin institucional arsimor, ju po thoni që kanë lëviz në plotësimin e kuadrit të kualifikuar, mirpo kemi shumë vende që nuk janë me kuadër të kualifikuar, na e dime qe kemi njerëz më të kualifikuar me 2-3 fakultete, mirëpo nuk mund të vin deri te punsimi i tyre.Brenga më e madhe është që gjinia femrore nuk është duke u përfshir sa duhet.

Mua më intereson,sa nxënës me nevoja të veqanta ka Komuna e Malishevës?

Kisha pasur dëshirë që institucionet shkollore të kenë edhe pavarësinë financiare, boll kanë qen të varura nga Komuna.

Drejtor, aneksi i shkollave a ka nevojë të ndërtohen, duke e ditur se kemi pak nxënës nëpër shkolla?

Keni cekur që keni bërë dhe kordinator me MASHT-tin që i keni trajnu, sa persona kanë qen në trajnimin nga Komuna e Malishevës?

Shumë shkolla janë ankuar për mungesë të mjeteve higjienike, munges të matësve të temperatures, a kemi

na mjek, motra medicinale që kanë shku nëpër shkolla dhe me ju mat dikujt temperature? A janë pajisur të gjithë nxënësit me maska? Ju faleminderit !

Rrahim Morina: Fjalën e ka Rajmonda Krasniqi.

Rajomda Krasniqi: Periudha e pandemis ka qen një prej periudhave më të vështira që ne e kemi kaluar si popull.

Kam disa pyetje drejtor :

- 1.Si është paraqitur dhe si është zhvilluar mësimi për parafillorët gjatë pandemis, a ka pasur ndonjë shkollë vështërsi të komunikimit për shkak të moshës së vogël që ata fëmijë kanë pasur dhe prindërve që ndoshta nuk kanë pasur mundësi të krijojnë komunikimin?
- 2.Te raporti i punës DKA-së përfshihet një pikë, ndarja e Ipad , sa Ipad kanë ardhur, sa nxënës kanë marr dhe cilët janë ata nxënës?
- 3.Sa drejtor të shkollave ju ka përfunduar kontrata e drejtorit ?
- 4.Në bazë të cilit vendim është rikthyer,pas shkarkimit drejtori i gjimnazit ‘‘Hamdi Berisha’’?
5. A kanë të gjitha shkollat në Komunën e Malishevës aparat mates për temperature ?
6. Si është vepruar me fëmijët me nevoja të veqanta në periudhen e pandemis?

Rrahim Morina: Fjalën e ka Valon Krasniqi.

Valon Krasniqi :Unë i kam dy pyetje:

- 1 .Shujtat për nxënësit, a i keni parapar këtë vitë, nëse jo cilat janë arsyet ?
2. Oborret e disa shkollave kanë filluar të rregullohen, mirëpo te disa shkolla ka ngecje të punimeve, cilat janë arsyet?

Rrahim Morina: Urdhëro drejtor!

Valon Mazreku: Faleminderit Kryesues! Po fillojë me Nebihin,emertimi i shkollës së Vërmices dy herë ka shku si procedurë në Ministri, herën e dytë nuk është kthi përgjigje ende. Donacion kemi 52 termometra digjital të UNICEF-it dhe OSAID-it, sot na lajmruan se duhet me shku me i marr në Prishtinë, nesër do të jenë këtu. Në takimin e rregullt me Ministrin e Arsimit dhe Përfaqësuesit e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik kemi ardhur në një përfundim se jo qdo nxënësi duhet t'i matet testi,por vetëm aty ku kemi simptoma.

Alban te çështja e kabineteve, pjesa më e madhe te kabinetet lëndore është pajisur me këtë çështje.Kabinetet e informatikës na kemi bërë kërkesen te Kryetari ,te pjesa buxhetit që është ndarë për teknologji prej Ministris së Arsimit 250.000€ për dy periudhat, periudhen para vitit të ri dhe periudhen deri në qeshor, 100.000 € i kemi planifiku për pajisje teknologjike, kemi kërkuar 250 lloptop për

mësimdhënës.

Te qështja e ujit, atë ditë ka qen ndërprerje dy orëshe. 17 shkurti ka pasur pengesa në ujë tri shkollat e Drenovcit nga ujësjellësi i Bajes dhe shkolla '' Imer Krasniqi'' ka pasur edhe qështje teknike të bunarit që e kanë, ajo është sanu. Në dy shkolla është dergu uji me qisterne dhe në Lladrovci është quar uji dhe është siguru uji.

Rrethojat e shkollave kanë nevojë, disa punime janë duke u bërë, por kjo është qështje se si punohet mbikqyrja nga Urbanizmi dhe shpresoj të realizohen. Te qështja e shkollës së Turjakes pajtohna që është e nevojshme, ka nevojë për pjesë shtesë. Investimi i nevojshëm dhe i realizueshëm mirë, i arsyeshëm është Turjaka dhe Ngucati që e kanë numrin e nxënësve statik dhe kanë nevojë me kalu me një ndrrim.

Për shujta të nxënësve kisha pasur dëshirë me marr dhe vendimin e juaj ,nesër e kam takimin si taksforca komunale dhe duhet të marr një vendim që të vazhdohet me shujta apo jo. Nuk kemi marrur ende vendim mirpo do e diskutojm dhe me prindër a me i dergu apo jo ,dhe të merret një vendim.

E-shkollori tani kemi fillu me regjistrimin, veq ka përfundu prej klases parë deri të nënten janë në procedurë të shpejtë me gjimnazin, pasi që vetëm gjimnazi është e vetmja shkollë që ka skenarin B që mësimi mbahet një javë në shkollë dhe një javë në shpi dhe kisha kërkuar te prindërit të kyqen të kenë qasje në E-shkollor sepse e kanë mundësin, e kanë kodin e vet dhe të nxënësit. Atë ditë kam thënë janë 4 te qështja e klasës me nxënës me nevoja të veqanta në '' Ibrahim Mazrek'' që ma nuk lejohe , tash do jenë me klasë të bashkangjitura dhe kanë nevojë për mbështetje. Ministria na ka leju 3 mësimdhënës mbështetës ne i kemi 4 dhe pse nuk na lejojnë me buxhet më shumë, dy kujdesen për këta 4 fëmijë, një e kemi në Bajë, një në Bellanic për nxënësit me nevoja të veqanta.

Furnizimi me tekste shkollore është bërë në gjitha shkollat, ka mungesë në 7-8 tekste por janë nëpër shkolla të ndryshme, dhe te mungesa e tekste tjera kemi bërë kërkes te furnizuesi që t'i sjell.

Mjetet higjienike, për 26 shkolla kanë ardhur nga donatorët dhe për shkollat që kanë pasur munges janë pajisur, asnjë shkollë nuk është pa dezinfektues, pa maska, pa paisje që duhet të jenë në shkollë.

Te autonomia financiare e shkollave, Komuna jonë ka filluar qe dy vite, por nëse shkojmë te autonomia financiare të shkollave që u përmend ,Berisha ,Tërpeza ,Gullbovci, dhe shumë shkolla tjera as pagat e mësimdhënësve sun i paguajn. Nëse ju dhajm autonomi financiare shkollat as paret për nxemje nuk mujn me i siguru. Drejtori gjimnazit është kthyer me vendim të Gjykates Supreme, ankesen që e ka bërë është kthyer. Ushtrues të detyrave të drejtorëve janë 7 apo 8 ,pse nuk është bërë përzgjedhja e tyre, ju e dini që është pezullu një kohë Ligji për Shërbyest Publik dhe kemi një telashe me këtë Ligj si trajtohet drejtori shërbyes civil apo professional dhe është në përfundim edhe Udhëzimi administrative që e kanë hartuar Ministria e Arsimit, unë besoj se shumë shpejt do hapet konkursi për ata drejtor.

Rrahim Morina:Faleminderit për pjesmarrje! Shihemi të marten në ora 10.

Vazhdimi i mbledhjes së -VI-(gjashtë) të rregulltë të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Mbledhja mbahet me date 29.10.2020 dhe filloi në ora 10:30. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: Kryetari i Komunës, 21 asambleistë, drejtorë komunalë dhe përfaqësues të mediave.

Rrahim Morina: Korum kemi 21 gjithsej prej 31-ve. Vetëm një mesazh e kam marr nga anëtarët e Kuvendit, një prej anëtareve të Kuvendit pomungojke, numrin e pash po emrin nuk munda të verifikoj, thotë nuk mundem me ardh për shkaqe shëndetësore të tjerët nuk kanë lajmëru mungesën e tyre. Atëherë fillimisht ju pershendes, Kryetarin e Komunës, anëtarët e Kuvendit, kabinetin qeveritar dhe gjithë të pranishmit në sallë. Të nderuar anëtarë të Kuvendit sot e kemi vazhdimin e seances dhe do ta hedhi në votim, që do të kthehem përsëri në pikën e dytë për leximin e dytë për shkak se këtë pikë atë ditë e kemi lënë mirpo më mire ta zyrtarizojmë dhe me votim, domethënë kthehem në pikën e dytë, vazhdimin e pikës së dytë, leximi dytë.

Kush është për ?

Për : 19

Kundër: 1

Apstenim: 1

Atëherë u kthëm në pikën e dytë, leximin e dytë propozim-Buxhetit të vitit 2021.

Urdhëro, Kryetar e keni fjalën! Tash është leximi i dytë dhe votimi i Buxhetit.

Ragip Begaj: Pershendetje Kryesues, pershendetje për të gjithë ju këshilltarëve të asambles, drejtorëve. Ne kemi paraqit një Projekt-Buxhet para juve dhe besoj se janë shtyllat kryesore. Buxheti komplet i vitit 2021 është 14.900.757 €, keni shtyllen paga dhe medijtje 8,363.200€, paga dhe shërbime 1,529.526€, shpenzimet komunale 455,000, subvencionet 400.000 dhe vlersimet kapitale 4,153.031€. Gati shumë shtylla nuk kemi nevojë dhe janë strikte nuk mundesh shumë me debat, problemi më i madh është të investimet kapitale besoj që janë munduar me u përfshi nevojat më të domosdoshme të qytetarëve tanë. Kisha kërku para juve që Buxheti të votohet, ky është propozim i imi dhe është e drejt e imja me paraqit Buxhetin para juve. Ju mund të debatonit është e drejt e juaja dhe vërejtjet janë të arsyshme për ne. Ne jemi përpjekur ta bëjmë punën tonë, besoj që kjo paraqitje e këtij projekt –buxheti para juve është e arsyeshme pavarësisht që nevojat dhe kërkesat janë shumë të mëdhaja mirëpo mundësit janë këto që

janë. Kisha dasht një unitet të votimi i buxhetit të Komandës së Malishevës, nuk kisha pas qef me na ndodh qysh na ka ndodh viteve të tjera, është e pamujshme krejt kërkesat mu mbulu, megjithatë Malisheva është shumë më mirë se sa kur ka qenë më herët dhe besoj që kushdo që do të jetë nesër do të jetë më mirë dhe do të jetë më lehtë ndoshta me i përmbush nevojat e qytetarëve tanë. Sot jemi më mirë se dje, nesër besoj do të jemi më mirë se sot. Unë ju dëshirojë sukses në punën e juaj.

Rrahim Morina: Faleminderit Kryetar, një qështje duhet ta bëjmë me dije, ju lutem anëtarë të Kuvendit do të vlejë ajo e cila ka qenë në leximin e parë, 15 minuta për shefa të grupeve dhe 10 minuta për anëtarë të Kuvendit, me që e kemi të vetmen pikë kështu që kemi hapsirë dhe kohë. Atëherë hapim debat rreth kësaj pike. Urdhëro Alban Krasniqi.

Alban Krasniqi: Faleminderit Kryesues! E para kam një vërejtje procedurale, që buxhetin ne e kemi bërë leximin herën e kalume dhe buxheti është dasht me u shqyrtu me një seancë tjetër, jo në vazhdim. Buxheti është ligj dhe unë në parlament praktikisht parlamentare për herë të parë tash po shohë që një dokument i tillë lexohet edhe një herë mbrenda seancës prapë lexohet për së dyti njëfar mënyre dhe votohet. Ky për mua është nonsens është dashtë dhe kërkoja që të bëhet një seancë e re, mirëpo e kuptoj presionin edhe ndikimi që është ba i atyre që Malishevën e kanë kap peng dhe vazhdojnë me kap, por jo dhe për shumë gjatë.

Kryetari tha: uniteti, po uniteti i mafisë politike të Malishevës që e kanë kap Malishevën dhe nuk ka me i shkuar gjatë sepse t'i po lyp unitet sot, kur natën je takuar me PDK fshehurazi që dy-tre netë, dhe nuk e keni pas publike që duhna me punu fshehurazi.

Mos harroni asambleista të dashur ky buxhet duhet mu realizu dhe ne jemi dëshmitarë të dy viteve të dështimeve të realizimit të tij. Pra, nëse ka pas fontan dëshirash është qiky qitash fontan dëshirash dhe ka me pas realizime mos harroni të pjesshme sepse dim njerëz ktu që kanë më shumë ndikim me drejtorët dhe Kryetarin, se mendoni se jeni dy parti. Jo, jo ju jeni ata asambleistat e rendit të dytë ju jeni asambleista të subjektit, subjekti i juaj ju trajton si asambleista të rendit të dytë. Për qata kqyrni napër fshatrat e juaj pse nuk janë të kryera shumica e investimeve, e në disa zona të caktuara të njerëzve që ky ka bashkëqeveris ma herët i realizojnë do gjana. Kqyrni mirë këtu asambleista të dashur, për me kuptu ku po përfundoni ju, në vegla të votimit.

Une vegël i votimit për vete nuk bahna dhe aty kur e di që sjam unë dhe anëtarët e Lëvizjes Vetvendosje, unë aty e di që ka Pazar dhe nuk ka ecje përpara dhe kta jam i sigurt në mënyrën qysh e kanë adresu këtë buxhet.

Veq na! Kqyrne një shembull e keni rrugën "Imër Krasniqi" në vitin 2021 domethënë 120.000€ kanë qen herën e kalume për zgjerimin e rrugës "Adem Jashari" jo në qef të ktyne, në realitet ktyne ju pret sytë edhe emri i "Adem Jasharit", andaj e kanë hekur për me zgjeru arterien kryesore të rrugës që e lidhë

Malishevën e kanë heq prej projektit,e kanë shty për një vjet.

Ju nxen rrugen dhe "Imer Krasniqi" andaj e kan hek dhe atë rrugë. A është me gju pare në lloq kjo? A është me gju pare në lloq Ragip Begaj?

A është kjo që e keni punu projektin natën dhe e keni punu me mendje të keqe, natën mund me kry dhe punë të mira se sun i kryen ditën dhe je i angazhuar do me ju dal pak ndihmë qytetarëve, por natën mundesh me ba dhe punë të pista qfare kanë ba këta njerëz. Besoni këtë herë të vendosur kemi qen që bashkarisht me kry buxhetin sepse e kemi pa që keq është planifikimi, ka qenë skandaloz dhe kena dasht me ba një planifikim të mirfilltë, por na u pa mundësunë.

Hiten servilat e ish-kryetarit që me moshë janë të re po janë aq të dëmshëm dhe të rrezikshëm për Komunën e Malishevës sa nuk ju merr mendja .Janë moshë e re me logjikë dhe me mendësi të shek XVIII (tetëmbëdhjet) sepse as Albanin e as Sylen e as njanin prej juve nuk e konsiderojnë qytetarë të rendit të pare, të rendit të dytë ju konsiderojnë.

Binduni, kjo është përtej politikës është qasje që duhet me luftu bashkarisht, se rrok Panorcin, nuk e rrok Drenovcin, nuk i rrok as Kravasarin as Carralluken as një fshat nuk e rrok. Kqyrne i keni në projekte i keni kërkesat e qytetarëve të cilat do t'i shqyrtojmë edhe na edhe ju bashkarisht tash.

Nëse hyjmë në rrafshin e investimeve bujqësore prej 80.000€ e kanë zbrit në 40.000€ faren edhe plehun, kta e dinë. Për të njejtut njerëz që 80.000€ herën e kulume ke taman dhe u duhke , të njejtut tash mendojn që duhet me hek në bujqësi duhet me hek gjysen e tyne. Profesor pazar ke ba nuk është ktu orientim kur t'i mendon se 80.000€ duhet per fara dhe për pleh, t'i mendon qdo herë se toka nuk ka mu ngushtu vitin tjetër bile gjasat janë mu rrit ma shumë kërkesat e njerëzve se në fillim. E kanë shti njejtën kohë 700.000€ mos harroni, e keni një rrugë e cila duhet mu shtru dhe mu rregullu veq kur të bahet plani harta zonale, veq kur Malisheva e ka një planifikim të mirfilltë ne atë hapsirë .

Nuk bashkëpunoj me juve me këtë logjiken e përjashtimeve pse ky katun është me atë parti ose i këti ose i ati. Fshati ka prioritete, mua më intereson prioritetet e fshatit, edhe në kanalizim kanë kqyr me i hek po si kemi leju. Ti prapë si ke shti të Bajes, po ke shku i ke shti 700.000 euro në livadhe me i shtru livadhet me asfalt 700.000€ e kanalizimet as në Bajë as në Carralluk nuk i ke përfshi .Pse me i hek investimet që janë të parapara për kanalizime?

Ndërtimi fushave sportive i kanë ba cop cop. Neve këtu në është than që me 20.000€ nuk ndreqet një fushë, deri në 40.000€ ka kushtuar projekti i një fushe. Qysh tash u ba me 20.000€, 35.000€ me u rregullu fusha dhe ndërtimin i fushës. Apo jeni tallur me ne dhe qytetarët. Keni shti projekte më shumë për mos me kry asnjërën.Kjo është fontan dëshirash, qysh janë fontan dëshirash parqet 5.000€ parqe në 7-8 fshate . As 5.000€ për një fshat nuk i bjen parqet ,sun i ndërton. Ti je tu rrejt qytetarin ,bane analizën. Propozimet e mia:

Ndërtimi i çerdhes në Bellanic 250.000€ ,te hiqet prej projektit 700.000€ që është i parapam me shtru

rrugën livadhet me asfalt me i ba prej ures së madhe të Malisheves deri atje posht andej.

Ndërtimi i çerdhes në Banjë 150.000€ është objekti, me 150.000€ rregullohet prej të njëjtit buxhet .

Ndërtimi i shkollës në Turjak, shkolla e vjetër për të cilën e kena diskutu këtë punë kthehet në çerdhe dhe fillon ndërtimi i shkollës së re 200.000€.

Ndërtimi i palestres sportive në Drenoc për shkollën "Bajram Curri" 100.000€ .

Ndërtimi i çerdhes në Carralluk, shkolla vjetër gjysma e shkollës vjetër ndahet për 100.000€.

Këto janë propozimet. Falemenderit !

Rrahim Morina: Urdhëro Valon e keni fjalën.

Valon Krasniqi: Pershendetje për Kryetarin Begaj, pershendetje për Kryesuesin e Kuvendit Rrahim Morina dhe për të gjithë kolegët e asambles Komunale. Të dashur kolegë, sa i përket buxhetit për vitin 2021 kemi diskutuar edhe javë më parë dhe propozimi i imi i asaj kohë ka qenë që kësaj radhe të jemi unifikues sa i përket punimit të buxhetit për vitin 2021, për shkak që kësaj radhe edhe qytetarëve ju kemi pasur borgj edhe për shkak të kësaj pandemie që uroj që sa më shpejt të largohet . Sa i përket qështjes së propozimeve apo amandamenteve që t'i qojm tutje edhe unë kam disa prej tyre, sepse jemi tradhtuar nga subjekti i cili kemi qenë një lloj kordinimi dhe bashkëpunimi për 3 vite me radhazi.

Kauza ka qenë ,Malishevës ti vie ndryshimi për të mirë dhe interes të qytetarëve të Komunës së Malishevës, por ajo nuk ndodhi . Avazi nga Partia Demokratike e Kosovës e cila në formë vetanake kaqyr me marr pushtetin në vitin që vjen në zgjedhjet lokale. Në momentin që u zbuluan të gjitha pazaret ndodhen ndërmjet pushtetit ekzekutivit kësaj radhe dhe Partis Demokratike të dashur qytetar prej mengjesit deri në mbrëmje në njëfar forme e kam kërkuar konfirmimin e shefit të grupit të PDK-së por ai në fund u pa që pazari është bërë me partin që është në pushtet .

Po ndërlidhna me propozimet konkrete të dashur kolegë:

Ujësjetesi në Panorc ka qenë një shqetësim edhe i kolegëve tone në mbledhjet e kalume dhe këtu në projekt-buxhetin për vitin 2021 nuk është përfshirë fare.

Palestra sportive në shkollën "Bajram Curri" në Drenoc këtë e kam cekur dhe në mbledhjen e kaluar por do ta ceki edhe tash.

Fshati i Ri propozoj që të jetë një fushë sportive. Të nderuar kolegë kërkoj nga ju besimin e juaj për lapidarian e dëshmorit "Afrim Krasniqi" te kroni në qendër të fshatit Bardh, vlera të jetë 20.000 euro.

Në fshatin Temeqinë kërkojë që rruga "Zaim Zabllaj" për rreth 400 metra të parashihet me asfalt.

Jam i pajtimit që të ndodh ndërtimi i çerdhes në Bellanicoë dhe në Banjë sepse Bajes i kemi borgj shumë sespse shume personalitete kemi nga fshati Banjë, ka personalitete të luftës ka personalitete të paqes. Po ashtu pajtohna me ndertimin e çerdhes në Carralluk po ashtu edhe shkolla në Turjak të filloj po në këtë vitë kalendarik.

Të dashur kolegë të dashur qytetarë të Komunës së Malishevës, të dashur kryetar të fshatrave dhe lokacioneve të Komunës së Malishevës, së pari i falenderoj kryetarët e të gjitha fshatrave për mundin dhe sakrificën që e kanë bërë gjatë kohës së pandemis pa asnjë pages nga institucionet komunale, ata kanë qenë heronjë të vërtetë për kontributin e tyre me bartjen e pakove ushqimore dhe higjienike që të ju dalin zot qytetarëve të fshatrave të tyre. Ju kërkoj falje publike që disa kërkesa të juaja apo 95% janë injoruar nga përfaqësues të cilët me vështësi janë bërë pjesë e asambles komunale, njerëzit me ka 200 vota ose 180 vota kanë përpiluar buxhet për vitin 2021. Kërkoj që të gjitha kërkesat e mia të hidhen në votim dhe të shohim kush nga kolegët po i qon para dhe kush nuk po i qon para. Plani i Hisni Kiles po ju betohna që nuk do të kthehet sa të jam unë dhe shumë shokë dhe plotë qytetarë që mbrojnë interesin e Komunës së Malishevës, për këtë do të bëjë qmës vetëm pse na ka tradhtuar.

Rrahim Morina: Ju kisha lutur për gjakftohësi, tolerancë, mirëkuptim. Sylë Dukolli e ka fjalën.

Sylë Dukolli: Pershendetje Kryetar, kolegë asambleistë. Së pari unë nuk kam fjalim të zjarrtë, nuk jam tu fol me dal në front. Unë kam fjalim për një kërkesë buxhetore që i'a kemi nisur me punë ditën e na ka zënë nata. Falenderoj për bashkëpunim grupin tjetër. Sa i përket buxhetit dal nga KPF-ja dhe Kryesuesi na kërkoj edhe shfaqje të grupeve që në vend të dëgjimit publik për shkak të Covid-it, t'i thirrur t'i shohim kërkesat e kryetarëve të fshatrave. Kanë qenë këtu dhe gjitha kërkesat e tyre janë të bartura, dhe 90% jemi të bazuar në buxhetin e vitit 2020 të propozuar atë kohë nga opozita dhe ato projekte nuk kanë mujt me t' realizu për shkak të rrethanave të kohës, të buxhetit. Të gjitha ato që nuk janë realizuar janë marr dhe janë qitur në buxhetin që e kemi përpara. Vitin e kaluar Kryetari i Komunës e ka pasur një kërkesë për Bajë 30.000€ me i ndar për çerdhe dhe nuk ka kaluar, salla sportit "Bajram Curri" nuk ka kaluar. Pjesa jem e punës ka qenë me t' fut gjitha kërkesat e kryeqepëve që kanë qenë këtu, pa ndarje, pa t' njeit, vetëm si kërkesa t' kemi marr dhe t' kemi trajtuar. Unë kërkoj ta qojm përpara këtë projekt.

Rrahim Morina: Faleminderit Sylë! Demir Bajra e ka fjalën.

Demir Bajra: Faleminderit Kryetar Begaj, Kryesues, pershendetje ju kolegë dhe kolege të asamblesë Komunale të Malishevës. Unë kam dal këtu, për do paknaqësi të miat. Nuk e di Kryetar është hera e tretë që barten projektet e vitit 2019 që i kemi votuar për 2020, janë projekte të njejtat nuk e dim qa kemi bërë me fatin e atyre projekteve. Më preku një rast këtu të prioritetet të fshatit Panore dhe Rud merre me mend uji është jetik besoj për krejt njerëzimin, por as për fshatin Panore as për fshatin Rud nuk po e shoh që është dha një metelik për këtë qështje. Një fshatin Rud janë futur 800 metra kanalizim për vien kryesore, nuk janë të parapame sivjet në buxhet dhe jemi shumë keq te një familje që ja kemi lanë kanalizimin midis pasuris dhe shprehi keqardhje për atë familje. Ka fshatra që me ndriqim janë mbulu janë shtuar edhe nga 30 trupa. Për fshatin Panore i kanë parapu 15 trupa, asnjë trup në fshatin Panoc nuk ka ndriqim publik. Kryesues kërkoj nga ju që për projektet e fshatit Rud dhe Panore ta hidhni në votim. Propozimet për fshatin Rud dhe Panore janë: Ujësjellësi, kanalizim, ndriqim publik, asfaltimi i rrugëve dytësore. Ju faleminderit!

Rrahim Morina: Ilaz Krasniqi e ka fjalën.

Ilaz Krasniqi: Faleminderit Kryesues! Pershendetje për të gjithë! Unë qëllimisht i mora kërkesat e kryeqepëve ose kryetarëve të fshatrave, të cilët i kemi thirrur këtu për t'i sjellur kërkesat e tyre dhe këto kërkesa asnjë nuk ka hyrë në këtë projekt-buxhet. Më vjen keq pse i kemi maltretu. Kam një

kërkes:Kanalizimi kryesor që lidh Terpezen e Ulët me Mirushen.Kryesues kanalizimi lagjia Peja në kolektorin kryesor në Mirushë, dhe një kërkes për 50 trupa ndriqim në fshatin Carralluk.

Rrahim Morina : Atëherë vazhdojm me Hidajete Mazreku.

Hidajete Mazreku:Falemenderit Kryesues.Pershendetje kryetar,pershendetje kolegë asambleistë, pershendetje drejtor. Ky buxhet i përpilur sot, është duhur me qen në leximin e parë, dhe sot që ka ardhur në leximin e dytë ka ardhur me vonesë.Valon i ke bërë do kanalizime do trotuare do ndriqime mirëpo për mu kryesore është pastrami i lumit Mirusha edhe tek stacioni edhe ktu nga 500 metra përmbi urë, përfundi urës është zero, pastërtia ka shumë rëndësi.

Disa rrugë disa kanalizimi i keni bërë por disa mua nuk më pëlqyen psh “Golesh” nuk ka ender kanalizim, e ti ke paraparë dhe asfaltt. Lagjia “William Voker” është anashkaluar prej 2010, tre vite jam asambleiste asgjë përpos 7 trupat që i ke ba, sen tjetër ske ba.

Valon qdo vitë jemi duke ndarë buxhetin për blerjen e librave të bibliotekës.A keni ble naj herë? Asnjë liber nuk ka, as me i tërek as për arsim as për qytetarët, vetëm donatorët qa i kan ble.

Sa i përket çerdhes së fëmijëve ju e dini që duhet mu planifiku ku mu ba çerdhja e fëmijëve, çerdhja e fëmijëve nuk bahet ku ka zhurmë ku ka frekuentim shumë të madh.

Edhe parqet nuk marohen ku frekuentohet rruga kryesore, si parku i Malisheves. Parku është ku ka ajër të pastër, ku ka pisha, ku ka lisa. Rrugët kryesore nuk janë për parqe.

Rrahim Morina:Luan Kryeziu e ka fjalën.

Luan Kryeziu:Pershendetje për të gjithë! Sa i përket buxhetit qe e keni thirr këtë mbledhje që është jo e rregulltë, që është në kundërshtim me ligjin, e konsideroj që buxheti është ligj në aspektin e fuqisë. Sa i përket buxhetit e vrejta që është një buxhet autoritar e cila bahet nga një grup i ngushtë i personave. Jam i bindur që mashtrimet e Nismas kanë me vazhdu në zgjedhjet lokale dhe në zgjedhjet qendrore ku do të jeni në pazare bashkarisht me PDK-në . Ky buxhet është buxhet i krimi, buxhet i cili bënë shkelje ligjore se 60 ose 70% të projekteve të vitit 2020 na e keni servu para vetes.Këtu ka vend që duhet me ba Prokuroria me kqyr pse nuk janë zbatuar këto projekte. Kur t'i sheh prokuroria që janë tejkalu kompetencat e personave zyrtar këtu, që nuk janë përfillur përfaqësuesit e asambles komunale, atëherë t'i shihni rezultatet. I bëjë thirrje Prokurorisë dhe organeve të tjera të drejtësis me e studiuar këtë qështje mirë, jo me na ik senet.

Rrahim Morina:Kastriot e keni fjalën.

Katriot Bersha: Falemenderit Kryesues! Pershendetje Kryetar, drejtor, kolegë asambleistë. Unë mendoj se ky projekt ka mangësi të mëdha sepse ka projekte që është hera e tret që futen në buxhet dhe janë të pa

realizushme. Fakti që ky buxhet është ba ndërmjet Nismes dhe PDK-së tregon se ka mangësi. U përfolke më herët që Fatmir Limaj apo Nisma do të shëndërrohet në PDK, vetë fakti i këtij bashkëpunimi po tregon që do shëndërrohen në një parti. Unë ju uroj sukses të dy partive në këtë bashkëpunim. Në emër të AAK-së ne në momentin e votimit të këtij buxheti do ta lëshojmë sallen. Falemenderit!

Rrahim Morina: Urdhëro Valon!

Valon Krasniqi: Unë kam dhe një propozim shtesë, që të gjitha kërkesat apo projektet e propozuara nga dega e LDK-së në Malishevë të futen në projekt buxhetin për vitin 2021 .

Rrahim Morina: Urdhëro, Alban Mazreku e ka fjalën.

Alban Mazreku: Përshendetje Kryesues, përshendetje kabinet qeveritar, të nderuar kolegë asambleistë, të nderuar qytetar të Komunës së Malishevës. Në këtë propozim buxhet investimet do të jenë dy vjeqare, sidomos të rrugëve dhe ndërtimi i rrugëve me kubza. Ndërsa sa i përket kërkesave të asambleistëve të tjerë, këto janë koga kërkesa mekalomane prej disa asambleistëve realisht është e pamundur që buxheti i Komunës me këtë investim kapital të përfshihen gjitha këto kërkesa. Grupi jonë i PDK do të votojë për këtë buxhet, dhe vota jonë do të jetë për. Faleminderit!

Rrahim Morina: Urdhëro Drejtor!

Valon Mazreku: Falemenderit Kryesues! Sa i përket investimeve që theksohet për Malishevën, qyteti i Malishevës deshtëm apo s'deshum na është dhe nuk mundet me mohuar askush. Janë diku mbi 4 kilometra kanalizime të cilat janë të planifikuara për me u rregullu në qytetin e Malishevës. Në lagjen "Gojleshi" janë 1500 metra, prej varrezave të dëshmorëve deri te Danajt që lidhet me kolektorin kryesor që vijen kanalizimi prej Lladrovci janë 1000 metra , te Luftëtarët e UÇK-së në rrugën "Hil Mosi" që është ndërmjet lagjes Gurit dhe Veseli, rrugën "William Woker", rrugën "Ibrahim Mazreku" te zjarrfiksat, kjo është sa i përket kanalizimeve në Malishevë.

Në Mirushë janë të planifikuara 1650 metra kanalizim, kanalizimi te shkolla dhe kanalizimi nga lagja Fusha e Bregut e deri te kolektori kryesor 1500 metra .

Në fshatin Panorc janë 1500 metra kanalizim, vazhdim i vijes kryesore në fshat 1000 metra dhe në rrugën "Xhevdet Sahitaj". Garaqeve janë 500 metra kanalizim. Po ashtu rinovimi i kolektorit kryesor të kanalizimit nga fshati Bubel si faza e parë janë të ndara 150.000.

Sa i përket rregullimit të ndriqimit publik në vitin 2019 profesoresh e nderume në Malishevë janë vendosur 165 trupa, në vitin 2020 janë 115 trupa janë projekte duke vazhdu në implementim, dhe për vitin 2021 në rrugën "Imer Krasniqi" janë duke u planifikuara 20 ndriques.

Po ashtu në lagjen Mirdita sekmenti i rrugës “Mitrush Kuteli” është e vetmja rrugë pa ndriqim.

Në Carralluk janë 40 trupa ndriques, në Drenovc janë 40 trupa në rrugët kryesore, në fshatin Panorc janë 50 trupa për vitin e ardhshëm vazhdim i rrjetit në rrugën kryesore.

Rregullimi, pastrimi i Lumit Mirusha duke filluar nga qyteti po ashtu ndertimi i rrugës prej ures kryesore deri te ura e mini tranzitit në të dy anët. Ky projekt parasheh shetitore, gjelbërim, shteg për çiklista, janë të ndara 700.000€.

Sa i përket asfaltimeve në qytetin e Malishevës janë 1850 metra në rrugën “William Woker”, “Luftëtarët e UÇK-së” dhe për lagjen e re në “Gojlesh” janë të planifikuara 1500 metra, po ashtu është hapja e rrugës nga lagjja Danaj deri te varrezat e dëshmorëve.

Në fshatin Panorc janë 1080 metra asfalt. Në fshatin Rud janë 700 metra asfaltim i rrugëve. Në fshatin Turjak janë 700 metra. Ky është buxheti që është i konsolidun me ligjin, është i harmonizun me gjithë ata që kanë pasur vullnet politik, moral dhe qytetar me i kontribu këti buxheti. Falenderoj të gjithë !

Rrahim Morina:Udhëro Kastriot !

Kastriot Berisha : Nisma dhe PDK-ja i kanë ba votat për këtë buxhet dhe kështu që kanë të drejtën me shti qka të dojnë, derisa e sigurojnë votën e vet. Drejtor desha me ta ba një pyetje . Ku janë ato projekte 2018-2019-2020 që kanë pas me u realizu? Pse nuk janë realizu .

7 fshatra marrin ujë prej fshatit Gurbardh, ndërsa fshati Gurbardh nuk ka ujë, dhe kanalizimet derdhen po në atë vend ku është uji i pishem, ku furnizohen 7 fshatra. Kanalizimet që janë me prioritet nuk kanë hyrë, kanë qenë vjet 1000 metra kanalizim për mos rre ra ujrata e zeza në ujin e pishem, nuk është realizu, është shtyr përsëri.

Drejtor ku janë projektet e viteve të më parshme? Pse nuk janë realizuar? Dhe nëse nuk janë realizu ku janë të hyrat , sepse ne i kemi nda mirëpo parat nuk janë.

Ky nuk është një buxhet i qytetarëve por mund ta quaj është një buxhet Nisma-PDK. Falemenderit!

Rrahim Morina: Avdi Morina e ka fjalën.

Avdi Morina: Faleminderit Kryesues! Përshendetje Kryetar, drejtor, të nderuar kolegë, të nderuar të pranishëm.Projekti i plotëson kërkesat dhe nevojat që kanë rrjedhur nga lagjet,fshatrat, nga kryetarët e fshatrave, nga përfaqësuesit e subjekteve politike. nga anëtarët të asamblesë komunale, i cili buxhet besoj se duhet të realizohet. I bëjë një kërkesë Kryetarit që dhe ne bashkarisht të ndihmojmë, që projektet që realizohen të kanë një mbyqyrje pak më të madhe që të dalin projektet sa më cilësore. Një vëmendje të posaqme duhet ti kushtojmë edhe sektorit të bujqësis sepse zona jonë është një vend që merret më shume me bujqësi dhe blektori. Sa i përket infrastruktures rrugore jemi një ndër Komunat më të mira që e kemi

të rregullume. Unë i bëjë ftesë gjithë kolegëve që ta mbështesin këtë projekt-buxhet. Faleminderit Kryesues.

Alban Krasniqi: Nuk është shkelje e rregullores së punës sepse t'i je që sa kohë dhe je kanë dhe Kryesues nëse nuk gaboj i Kuvendit, nënkryetar dhe nuk i din rregullat bazë sepse kurrë s'ke vepru në bazë ligjore. T'i vepron veq me jarani e keni kryë këtë punë. Ka kalu ajo kohë ma, jo sipas meje por sipas realitetit. Kjo tendencë jote me mbyll debatin, kjo tregon karakterin tënd bashkë me të atyne me të cilët t'i ke punu me për këtë shkarravin ktu.

700.000 € shkon i gjuan në bërlllog, nuk je në gjendje me i qit në vende elementare që kanë nevojë, e nisum një iniciativë bashkë për çerdhen t'i tërhiqesh sepse me një telefonat tërhiqesh. Ju po e pamundësoni Malishevën e u zhvillu dhe me u shëndrru në qytet sepse keni konflikt interesi një, dy keni mendësi të ngushtë, ju ende jeni në shek XIX jo në shek XXI dhe kjo është e keqja e Malishevës.

Kta është dasht me reflektu kur ne kemi dasht këtë vit ta bëjmë gjithpërfshirës buxhetin sepse skandaloz është i përgaditur edhe sot nuk e dim na për kapitale, ato që na i kemi kërkuar as për kapitale nuk na kan për të shkruar dhe planifikim që këta e kanë për projektet të cilat planifikohen për mu realize edhe ato nuk i kan sjellë.

Rrahim Morina: Ora është 12:05 a vazhdojmë me votim apo shkojmë me pushim? Kush është me vazhdu seancën? Me ngritje dore ju lutem!

Për: 16

Kunder: 2

Apstenim: 4

Atëherë seanca vazhdon. Shkojmë te propozimet : është propozimi i Alban Krasniqit, propozimi i Valon Krasniqit, propozimi i Demir Bajra, propozimi : Ilaz Krasniqit.

Rrahim Morina : Propozimi i Alban Krasniqit:

-Ndërtimi i çerdhes në Bellanë 250.000 €.

-Ndërtimi i çerdhes në Banjë 150.000 €.

-Ndërtimi i shkollës në Turjak 200.000 € ,

-Ndërtimi i palestres sportive në Drenoc për shkollën "Bajram Curri" 100.000 €,

-Ndërtimi i çerdhes në Carralluk 100.000 €.

Kush është për me ngritje dore?

Për: 9

Kundër : 13

Apstenim : 5. Propozimi i Albanit nuk kalon

Rrahim Morina : Propozimi i Valonit janë:

-Ujësjetlesi në Panorc ,

-Ndërtimi i palestres sportive në Drenovc ,

-Palester sportive në shkollën “Bajram Curri” Fshati i Ri, lapidari i dëshmorit “Afrim Krasniqi” te kroni në qendër të fshatit Bardh vlera të jetë 20.000 € ,

-Në fshatin Temeqinë asfaltimi i rruges “Zaim Zabllaj” për rreth 400 metra,

-Ndërtimi i çerdhes në Bajë,

-Ndërtimi i çerdhes në Carralluk,

-Ndërtimi i rruges “Jadrazh” 250 metra.

Kush është për me ndritje dore?

Për :6

Kundër: 14

Apstenim :4 . Propozimi i Valonit nuk kalon

.

Rrahim Morina: Propozimet e Demirit janë:

-Rregullimi i ujësjetlesit të fshatit duke investuar në shtrimin e kapaciteteve të ujit të pijes,pasi ekziston burimi natyror i ujit dhe ujsjellësit të ujit jo funksional në fshatin Panorc dhe Rudë Ndriqimi publik në rrugën kryesore “Milaim Bajrami” 8 trupa, rruga “Ellaci” 10 trupa, rruga e “Gjamies” 6 trupa. rruga “Vera” 8 trupa. rruga “Xhemajli Bajra” 6 trupa. rruga “Esat Rexha” 5 trupa këto janë propozimet e fshatit Panorc.

-Propozimet e fshatit Rudë: trotuar me gjatësi 1 kilometer e gjysmë. kanalizimi me gjatësi 800 metra.

Kush është për me ngritje të dorës ?

Për: 9

Kundër:8

Apstenim:4 . Propozimi i Demirit kalon.

Rrahim Morina: Propozimi i Ilaz Krasniqi:

-Kanalizimi lagjja Bejhra te kolektori kryesor Mirusha 3500 metra,

-50 trupa ndriqim në Carralluk.

Kush është për me ngritje dore?

Për: 11

Kundër :16. Nuk kalon as propozimi Ilazit.

Rrahim Morina: Rruga "Lam Seferi" 170 metra,

- rruga "Qamili i Vogël".

Kush është për me ngritje të dores?

Për:11

Kundër:14 Nuk kalon as ky propozim.

Rrahim Morina: Propozim -Buxheti i propozuar nga Kryetari i Komunës.

Kush është për me ngritje dore?

Për: 17

Kundër: 0


Apstenim: 3

Urime qytetarëve të Komunës së Malishevës buxheti i vitit 2021.

Mbledhja përfundoi në ora 16:30.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina



Kryesuesi i Kuvendit:

Rrahim Morina

